




KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



Bazuar në Nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryeshefi Ekzekutiv në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH. A në Prizren, me datë 08.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

Anulohet Konkursi i Jashtëm Nr.2703 të datës 05.05.2026 i publikuar në web faqen e Kompanisë dhe rrjete sociale për plotësimin e vendit të punës për pozitën e punës Udhëheqës i grupeve për Inspektorat/kontroll dhe shkyçje në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH. A. Prizren.

Arsyetim

Nga raporti Nr.Pr. 819 të datës 03.06.2026 i Komisionit të Vlerësimit rezulton se asnjëri nga kandidatët e paraqitur në këtë procedurë nuk e ka arritur pragun minimal të pikëve për kalimin e testit me shkrim, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në konkurs dhe në Rregulloren Nr.3110 të datës 02.08.2026 për Rregullimin e procedurave të konkursit në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH. A në Prizren.

Meqenëse kalimi i testit me shkrim është kusht për vazhdimin e procedurës së vlerësimit dhe pjesëmarrjen në fazat e tjera të përzgjedhjes, procedura e rekrutimit nuk mund të vazhdojë, duke qenë se asnjë kandidat nuk ka kaluar testin me shkrim dhe rrjedhimisht nuk plotësohen kushtet për vazhdimin e procedurës së rekrutimit, andaj është vendosur anulimi i konkursit për pozitën Udhëheqës i grupeve për Inspektorat/kontroll dhe shkyçje në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH. A. Prizren.

Vendimi të i dorëzohet :

- Njësisë së Burimeve Njerëzore,
- Anëtarëve të Komisionit vlerësues, dhe,
- Arkivit.

K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A

Bekim Gashi
Kryeshef Ekzekutiv